

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA GLLOGOC**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **611-26-5285-5-2-1**

Sa i përket tenderit për **INSTALIMI I NXEMJEVE QENDRORE -RIPARIMI I KULMIT NE SHMU XHELADIN GASHI-PLAKU - KOMORAN-Ritenderim**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	Treing SH.P.K.
NUI	812136522
Adresa	Rruga Dëshmorët e Ponoshecit, 69
Vendi	Prishtinë
Kodi postar	10000
Numri Telefonit	049293969
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Uljan Thaçi
Adresa elektronike	3ingshpk@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	14.09.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

INSTALIMI I NXEMJEVE QENDRORE -RIPARIMI I KULMIT NE SHMU XHELADIN GASHI-PLAKU - KOMORAN-Ritenderim

Aktiviteti aktual paraqet ritenderim të aktivitetit të mëparshëm me të njëjtin objekt kontrate.

Për këtë aktivitet dhe objekt kontrate janë zhvilluar tashmë dy procedura shqyrtuese pranë OSHP-së, përkatësisht lëndët 2026/0350 dhe 2026/0515.

Me Vendimin nr. 2026/0350, Paneli Shqyrtues kishte përcaktuar se, nëse AK e ritenderon aktivitetin, duhet të veprojë konform dispozitave ligjore dhe rekomandimit të ekspertit shqyrtues.

Më pas, me Vendimin nr. 2026/0515, ankesa e OE Treing SH.P.K. është aprovuar pjesërisht dhe AK është obliguar të bëjë përmirësimet në Dosjen e Tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim. AK është obliguar gjithashtu ta informojë OSHP-në për veprimet e ndërmarra, ndërsa për mosrespektim të vendimit është paraparë mundësia e masave sipas nenit 131 të LPP-së.

Pas publikimit të Dosjes së korrigjuar më 27.08.2026, OE Treing SH.P.K. ka konstatuar se një pjesë e konsiderueshme e kriterëve të kontestuara vazhdojnë të mbesin në fuqi, disa janë ndryshuar vetëm formalisht, ndërsa disa kërkesa të larguara më parë janë rikthyer.

Për këtë arsye është parashtruar Kërkesa për Rishqyrtim e datës 01.09.2026, e cila është refuzuar nga AK.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Referoju kërkesës për rishqyrtim

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Nenet 1 dhe 6 të LPP-së;

Nenin 7 të LPP-së;

Nenin 27 të LPP-së;

Nenin 69 të LPP-së;

Nenin 108/A të LPP-së;

dispozitat relevante të Rregullores për Prokurimin Publik lidhur me qartësinë, relevancën dhe proporcionalitetin e kriterëve;

Vendimin e OSHP-së nr. 2026/0350;

Vendimin e OSHP-së nr. 2026/0515.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Pretendimi nr. 1

AK ka bërë disa korrigjime, përfshirë largimin e frezës, zvogëlimin e kontejnerit dhe ndryshimin e disa certifikimeve. Këtë nuk e kontestojmë.

Megjithatë, eksperti teknik kishte përcaktuar një standard shumë më të qartë: kërkesat për staf, certifikime dhe pajisje duhet të lidhen drejtpërdrejt me **punën konkrete, sasinë, nevojën teknike dhe funksionin real.**

Në seancën kryesore eksperti ka deklaruar shprehimisht se:

“Nuk ka nevojë për staf teknik kaq voluminoz, pasi nuk po bëhet nga bërthama, por është renovim.”

Paneli Shqyrtues e ka marrë parasysh këtë konstatim dhe ka obliguar AK-në të bëjë përmirësimet në Dosjen e Tenderit.

Megjithatë, Dosja e korigjuar vazhdon të përmbajë pikërisht disa nga kriteret e kontestuara, ose versione të riformuluara të tyre, pa lidhje të qartë me pozicionet konkrete të paramasës.

Prandaj konsiderojmë se kemi të bëjmë me **korrigjim formal dhe jo zbatim substancial** të Vendimit të OSHP-së.

Pretendimi nr. 2

Në Dosjen e korigjuar AK kërkon:

“Një (1) Teknik Arkitekturës të jetë i licencuar për punë ndërtimore nga institucionet shtetërore (licence pune A2-3 për punë ndërtimore).”

Pikërisht ky kriter ishte trajtuar nga Paneli Shqyrtues, i cili kishte konstatuar se AK duhet ta analizojë kërkesën, pasi nuk dihej **çfarë licence kërkohet dhe nga cili institucion duhet të lëshohet.**

Dokumentet e bashkëngjitura Kërkesës për Rishqyrtim tregojnë se licenca A2-3 e identifikuar është lëshuar nga MKRS në fushën e **trashëgimisë kulturore**, ndërsa përfituesi kategorizohet si **Teknik i Ndërtimtarisë.**

Prandaj mbeten të paarsyetuara tri çështje thelbësore:

pse për një renovim standard të një objekti shkollor kërkohet licencë e fushës së trashëgimisë kulturore; pse ajo kërkohet për “Teknik Arkitekture” kur licenca e identifikuar i referohet Teknikut të Ndërtimtarisë; dhe cila është baza ligjore dhe profesionale për pikërisht licencën A2-3.

Problemi nuk është vetëm teorik.

Në aktivitetin **“Ndërtimi i fushave sportive Komoran, Korrekticë e Epërme dhe Arllat”**, ku kanë ofertuar pesë operatorë/grupe operatorësh, nga dokumentet e AK-së rezulton se te **katër prej pesë ofertuesve** kriteri për Teknikun e Arkitekturës është

evidentuar si një nga kërkesat e paplotësuara.

Në një aktivitet tjetër të të njëjtit AK, **“Ndërtimi i SHFMU Rasim Këçina – paralele e ndarë në Shtrubullovë”**, është përdorur përsëri i njëjti kriter, ndërsa është pranuar vetëm **një tender**.

Nuk pretendojmë se vetëm ky kriter ka qenë shkak i eliminimit apo mungesës së ofertuesve, por këto të dhëna dëshmojnë se kriteri ka **efekt të dukshëm kufizues në konkurrencë**.

Kërkojmë që kriteri të largohet ose të riformulohet në mënyrë të qartë, proporcionale dhe profesionale, duke lejuar kualifikime relevante dhe të barasvlershme.

Pretendimi nr. 3

Kërkesa jonë nuk ka qenë që të largohet çdo staf profesional. Kemi kontestuar vetëm kërkesat dhe certifikimet që nuk mbështeten qartë në paramasë.

Teknik Ndërtimtarie – Murator me diplomë/certifikatë. Dosja vazhdon të kërkojë murator me diplomë ose certifikatë. Eksperti teknik ka konstatuar se paramasa përmban vetëm rreth **16 m_ç muratim standard** dhe se për këtë punë mjafton një murator i aftë dhe me përvojë; nga paramasa nuk rezulton nevoja për certifikatë të posaçme. Kërkojmë largimin e certifikimit të posaçëm.

Teknik Elektrike – Instalues elektrik i certifikuar për energji, klimatizim dhe mjedis. Dosja vazhdon ta përmbajë këtë kërkesë. Eksperti ka konstatuar se punimet janë instalime standarde elektrike të tensionit të ulët dhe se certifikimet shtesë për klimatizim, mjedis dhe mbrojtje nga zjarri nuk lidhen me pozicionet elektrike të paramasës. AK ka larguar vetëm një pjesë të certifikimeve, ndërsa të tjerat i ka mbajtur pa arsyetim teknik të ri.

Specialisti për montim/saldim të tubave PE/HDPE. Dosja vazhdon të kërkojë punëtor të certifikuar për montim/saldim PE/HDPE. Eksperti ka konstatuar se ky certifikim mund të kërkohet vetëm nëse përcaktohen qartë **materiali, mënyra e bashkimit, standardi dhe sasia e punimeve**. Në Dosjen e korrigjuar këto elemente vazhdojnë të mos përcaktohen. Prandaj kriteri mbetet i paarsyetuar.

Teknik i Makinerisë i certifikuar si instalues i tubave dhe sistemeve të ngrohjes qendrore. Dosja vazhdon ta kërkojë këtë certifikim. Nga paramasa rezulton vetëm demontimi dhe rimontimi i tetë radiatorëve ekzistues, pa kaldajë, pompë qarkulluese apo rrjet të ri të plotë të ngrohjes.

Edhe gjatë seancës eksperti ka qenë i qartë: **profili makinerik mund të jetë i arsyeshëm, por certifikimi specifik është i panevojshëm**.

Prandaj kërkojmë riformulimin e kriterit duke larguar certifikimin specifik që nuk

mbështetet në punët reale.

Inxhinieri/Masteri i Menaxhimit të Emergjencave. Në Dosjen e korrigjuar vazhdon të figurojë kjo kërkesë, madje me formulim të paplotë.

Kjo kërkesë është edhe më problematike sepse në fazën e mëparshme vetë AK e kishte **larguar** kriterin për ekspert të Menaxhimit të Emergjencave/Mbrojtjes nga Zjarri.

Nga paramasa nuk rezultojnë sisteme të specializuara të mbrojtjes nga zjarri apo ndonjë punë konkrete që kërkon këtë profil. Edhe në Kërkesën tonë për Rishqyrtim është kërkuar që AK të identifikojë **cilën punë konkrete të paramasës do ta kryejë ky profil dhe pse ajo nuk mund të mbulohet nga personeli tjetër profesional.**

Rikthimi i një kriteri të larguar më parë, pa punë të reja në paramasë dhe pa analizë të re teknike, është i pajustificueshëm.

Pretendimi nr. 4

Në Dosjen e korrigjuar AK vazhdon të kërkojë ndër të tjera:

minidamper max. 500 kg, mini-eskavator max. 900 kg dhe Mini Bobcat max. 2 ton.

Paneli Shqyrtues ka mbështetur konstatimin e ekspertit se pajisjet duhet të jenë **funksionalisht të barasvlershme**, nëse ato mundësojnë realizimin e sigurt dhe cilësor të punimeve.

Ndryshimi, për shembull, i Mini Bobcat nga maksimum 950 kg në maksimum 2 ton nuk e zgjidh problemin nëse AK ende nuk shpjegon pse pikërisht 2 ton është kufiri teknik i nevojshëm.

Nëse ekziston kufizim real i hyrjes, terrenit apo kapacitetit mbajtës, AK duhet ta identifikojë dhe dokumentojë. Në të kundërtën, pajisja duhet të kërkohej sipas **funksionit**, duke lejuar mjete ekuivalente.

Pretendimi nr. 5

Secili kriter duhet të jetë relevant dhe proporcional edhe individualisht, por duhet të vlerësohet edhe efekti i tyre i përbashkët.

Kur mblidhen kërkesat për licencë të paqartë A2-3, certifikim të posaçëm për murator, certifikime shtesë për instaluesin elektrik, specialist PE/HDPE, certifikim specifik për sisteme të ngrohjes, profil të Menaxhimit të Emergjencave dhe pajisje me kufij të ngushtë teknike, krijohet barrë e konsiderueshme për operatorët ekonomikë në një aktivitet që

eksperti e ka karakterizuar si **renovim të objektit ekzistues**, jo objekt kompleks.

Vetë eksperti ka konstatuar se, kur kërkesat pa lidhje të qartë mblidhen së bashku, operatori detyrohet të sigurojë staf dhe pajisje që mund të mos jenë të nevojshme për realizimin real të kontratës.

Në vendimin e fundit, AK arsyeton se ka marrë për bazë vetëm Vendimin e Panelit dhe jo raportin e ekspertit dhe se pretendimet që dalin jashtë Vendimit të Panelit nuk janë shqyrtuar.

Ky arsyetim nuk qëndron, sepse Paneli vetë ka marrë parasysh raportin e ekspertit, seancën dëgjimore dhe të gjitha provat relevante gjatë nxjerrjes së Vendimit nr. 2026/0515.

Për më tepër, pretendimet tona lidhen me **Dosjen e korrigjuar pas Vendimit të Panelit**. AK nuk mund të ndryshojë ose rikthejë kriteret dhe pastaj të refuzojë shqyrtimin e tyre me arsyetimin se formulimi i ri nuk ka qenë pjesë e vendimit të mëparshëm.

Bazuar në faktet dhe provat e paraqitura, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që:

1. **TË APROVOJË** si të bazuar ankesën e OE Treing SH.P.K.;
2. **TË ANULOJË** vendimin e AK-së mbi Kërkesën për Rishqyrtim;
3. **TË OBLIGOJË** AK-në të zbatojë në mënyrë substanciale Vendimin nr. 2026/0515;
4. **TË LARGOJË** ose riformulojë kriterin për Teknikun e Arkitekturës/licencën **A2-3**, duke eliminuar paqartësinë dhe duke lejuar kualifikime relevante e të barasvlershme;
5. **TË LARGOJË** certifikimin e posaçëm për muratorin, pasi nuk mbështetet në vëllimin e punimeve;
6. **TË LARGOJË** certifikimet jorelevante për instaluesin elektrik, të cilat nuk lidhen me punët elektrike të paramasës;
7. **TË LARGOJË** kërkesën për specialist PE/HDPE, përveç nëse përcaktohen konkretisht materiali, standardi, mënyra e bashkimit dhe sasia e punimeve;
8. **TË LARGOJË** certifikimin specifik për instalues të sistemeve të ngrohjes **qendrore**, duke mbajtur vetëm profilin profesional që realisht kërkohet nga punët;
9. **TË LARGOJË** kërkesën për Inxhinier/Master të Menaxhimit të **Emergjencave**, në mungesë të punëve konkrete që e bëjnë këtë profil të nevojshëm;
10. **TË RIFORMULOJË** kriteret për pajisjet sipas funksionit, duke pranuar pajisje funksionalisht të barasvlershme dhe duke larguar kufijtë arbitrarë të peshës;
11. Pas korrigjimit të Dosjes, **TË ZGJASË afatin për ofertim** sipas dispozitave të LPP-së;
12. Duke marrë parasysh se aktiviteti është trajtuar tashmë nga OSHP dhe se Vendimi nr. 2026/0515 ka paraparë masa në rast mosrespektimi, **OSHP të vlerësojë zbatimin e nenit 131 të LPP-së**.

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Kriteret e kundërshtuara kufizojnë mundësinë e OE Treing SH.P.K. për pjesëmarrje efektive dhe të barabartë, duke krijuar shpenzime të panevojshme për sigurimin e stafit, certifikimeve, licencave dhe pajisjeve që nuk rezultojnë të domosdoshme nga paramasa.

OE është detyruar gjithashtu të përdorë në mënyrë të përsëritur mjete juridike për të njëjtin aktivitet, ndonëse një pjesë e çështjeve janë trajtuar tashmë nga ekspertët dhe Paneli Shqyrtues.

Dëmi përfshin shpenzimet për përgatitjen e ofertës dhe mjeteve juridike, rrezikun e eliminimit mbi bazën e kriterëve joproporcionale, humbjen e mundësisë për konkurrim të barabartë dhe fitimin potencial të munguar.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*